

Njoftim Për Shtyp Datë 9 Mars 2022



9 March, 2022 by KLGJ in NJOFTIME PËR SHTYP

Sot, në datën 09.03.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si vijon:

Këshilli vendosi miratimin si anëtare e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor të anëtares, znj. Marsela Dervishi, e zgjedhur me shortin publik të datës 08.03.2022 duke e shoqëruar me ceremoninë e betimit.

Në vijim, Këshilli vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z.{...} me funksion gjyqtar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, në datë 29 Mars 2022 ora 11:00.

Ndër të tjera KLGJ-ja miratoi vendimin për një ndryshim në listen e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.315 datë 22.07.2021.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, miratoi ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023. Ky komision përbëhet nga: z. Ilir Rusi, z. Ridvan Hado dhe znj. Irena Plaku.

Pas përtëritjes së KLGJ-së me dy anëtarë të rinj ishte i domosdoshëm ndryshimi i përbërjes së Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, ku si anëtare u zgjodh znj. Yllka Rupa. Ndërkohë përmes procedurës së shortit u zgjodh anëtar zvendësues në përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, për vitin 2022, z. Ilir Rusi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, miratoi plotësimin e tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë të kandidatëve: znj. Altina Nasufi, znj. Enkelejda Metaliaj dhe z. Valbon Çekrezi.

Këshilli gjithashtu, miratoi disa shtesa në Vendimin nr. 44, datë 31.01.2022 të KLGJ-së “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. Igerta Hysi”.

Pas kërkesave të përcjella nga disa gjykata, Këshilli miratoi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta.